


DHULKARNEJN VARDARI

TREGIME ISLAME  
PËR FËMIJË



DJALI  
HALLALL

DHULKARNEJN VARDARI

# ***DJALI HALLALL***

- tregime islame për fëmijë -

*Logos-A*  
1420/1999



Recensent  
*Ymer Musa*

CIP – Katalogizacija i publikacija  
Narodna i univerzitetska biblioteka "Sv. Kliment Ohridski",  
Skopje

821.18(73) (02.053.2)-32

**VARDARI**, Dhulkarnejn

Djali hallall : tregime islame për fëmijë / Dhulkarnejn Vardari;  
[ilustrimet dhe kopertina Smajo Musoviq]. – Shkup :  
Logos – A, 1999. – 80 str. : ilustr. ; 22 sk. - (Biblioteka Tregime Islame)

Dy-tri fjalë / Ymer Musa: str. 3-4

ISBN 9989-601-95-X

## DY - TRI FJALË

*Të nderuar shkollarë,*


*Librin që e keni në duar është punimi i dytë i autorit i cili po e përjeton shfletimin nga masa e gjerë pas atij "Njëqind pyetjeve - përgjigje", që e botoi Qendra Islame Kulturore Shqiptare në Nju-Jork në vitin 1993. Meqenëse autori i nderuar në bibliotekën e tij personale zotëron një sërë librash dedikuar filloristëve, të cilët për nga vëllimi i kalojnë të njëmijtat faqe e për kah vlera e tyre edukative janë bukë e ujë për më të dashurit tanë, kam nderin por edhe detyrën që po merrem me përgatitjen e këtij korpusi librash, që ta shohin dritën e tyre me anë të botimit. Brenda librit do të hasni në nëntëmbëdhjetë tregime, prej të cilave shtatë të parat janë tregime origjinale të autorit ndërsa të tjerat janë të përmbledhura nga libra e revista të nënqiellit islam.*

*Shpresoj se do të jetë kënaqësi e madhe për më të rinjtë tanë, por kënaqësi edhe më e madhe për prindërit e tyre që përmes leximit të kësaj përmbledhje tregimesh të shkurtra do të përfitojnë shumë në fushën e etikës dhe moralit për të cilat aq shumë është i nevojshëm brezi i ri sot. Nëse këto krijime të kësaj natyre - por*

*edhe të tjerat - të vëllait tim të dytë pas atij të nënës, arrij që me ndihmën e Zotit t'i radhisë midis kopertinave, më mban shpresa se do të mund t'ia shpreh dashurinë dhe respektin që e kam ndaj tij ose, sadopak t'i çmoj të mirat dhe kujdesin që i shprehu ndaj meje gjatë studimeve të mia universitare në Kajro.*

*Ymer Musa*

*Dhjetor, 1998 / Sha'ban, 1419, New York*



## SIKUR TË ISHTE NË RRUGË TË KEQE


Ishte plak. Ai kishte lëshuar vendlindjen dhe e kishte marrë rrugën e mërgimit të përherëshëm. Meqë fëmijët i kishte ende të vegjël, ai ishte i vetmi që punonte. Ishte dëshirë e All-llahut që fëmijët e parë t'ia merrë e të mbramit t'ia lë. Plaku ndjente një dashuri të thellë ndaj fesë së All-llahut të Madhërishëm dhe ndaj diturisë. Për këtë arsye, përkundër asaj që ishte i vetmi që punonte edhe atë për një rrogë tejet të vogël, djalin e tij të vetëm e kishte çuar në një medrese të Kur'anit që ta mësonte Kur'anin përmendsh, pra, që të bëhet hafiz. Vetë i katërti në shtëpi e madje dhe djali në medrese. Megjithatë i mbështetur në All-llahun aspak nuk mërzitej.

Puna që e bënte ai ishte punë nate, kështu që shpeshherë namazin e sabahut e falte në xhaminë e medreses ku mësonte i biri, ngase ajo ishte afër vendit të tij të punës. Një ditë përsëri erdhi në xhaminë e medreses për ta falë namazin e sabahut. Pas namazit, u ndal një kohë që të bisedonte me të birin.

-Si je, o djali i babës?

-Elhamdulillah, mirë jam o babë, po ti si je, a lodhesh me punë?





-O bir, baba për ju nuk lodhet kurrë. Përderisa jeni në rrugë të All-llahut, mua edhe më tepër më shtohet fuqia.


I biri sa mori guximin t'i thoshte diçka të jatit, gjendja e vështirë materiale e frenoi dhe nga goja e tij e hapur nuk doli asnjë fjalë.

Babai sikur e hetoi dhe i tha: -Mos vallë diçka deshe të më thuash?

Meqë babai tregoi interesim, i biri u trimërua dhe i tha: -Po babë! Një shok imi është duke shitur disa libra shumë të mirë me çmim tejet të volitshëm!

Tani edhe babai mbeti pa fjalë. Meqë para nuk kishte, e as që mund t'i përgjigjej të birit me po ose jo.

-Ta shofim deri nesër, All-llah kerim (All-llahu është bujar), -mezi u përgjigj i jati. Duke u ndarë nga djali, mendimet sikur ia rëndonin hapat. Mendohej, a t'i merrte hua patronit për librat që aq shumë i donte djali apo jo. I thelluar në mendime filloi të fliste vetë me vete dhe thoshte: "Sikur të ishte në rrugë të keqe e të kishte hyrë në borxh për bixhoz, për alkool, për vjedhje e të këqija të tjera, do të detyrohesha dasht e pa dashtë t'i gjej këto të holla, e ndoshta edhe më tepër." Të nesërmen, pa ia nisur punës, i mori të hollat nga patroni i cili kishte respekt të veçantë ndaj tij. I qetësuar dhe i kënaqur ia dha të hollat djalit. Ai i bleu librat i vuri nën sqetull dhe mori rrugën për në shtëpi. Nga gëzimi nuk e dinte a ecte apo fluturonte.



## DRITA


Një natë siç e kishim zakon, pasi që babai im ishte kthyer prej xhamie dhe e kishte falur akshamin, e pyeti nënën:

-Mori, a është darka hazër?

-Po o njeri, tash do ta vë sofrën, -iu përgjigj nëna .

Motrat i ndihmuan nënës e bashkë me to edhe unë dhe kështu me të shpejtë sofrë u shtrua. E gjithë familja jonë që numëronte pesë anëtarë ishim ulur rreth sofrës së vogël. Darkën që e kishte përgatitur nëna ime, e që për ne ishte më e mira në botë, ishim duke e ngrënë me lezet. Duke bërë muhabet e duke e ngrënë darkën, kur ja përnjëherë u fikën dritat. Mbetëm në errësirë. Syri syrin nuk e shihte. Babai - Allahu i dhashtë selamet atij - kishte shumë dëshirë që t'i shfrytëzojë rastet e këtilla. Ai vërtet nuk ishte shkolluar por megjithatë, vitet e kishin shkolluar shumë. Edhe me këtë rast siç e kishte traditë e vuri gurin në vend të vetin. Pasi që u kollit për ta sjellur qetësinë dhe për ta kthyer vëmendjen kah ai, filloi:

-O fëmijë të babës, a shihni se si u ndal drita dhe si mbetëm në errësirë! Aq sa nuk po mundemi as ta shohim njëri-tjetrin. A mund të më



thoni se kur ishte më mirë, kur kishte dritë apo tani pasi u fikën dritat? Të gjithë njëgojazi iu përgjigjëm:

-Kur kishte dritë ishte më mirë, o babë.

Më pas vazhdoi:


-Kështu është edhe me rrugën e drejtë, me Rrugën e All-llahut. E gjithë ajo është dritë, andaj edhe të nxjerrë në dritë, në xhennet, i cili i tëri është dritë. Errësira, me babën, është rruga e drejtë që ju çon në errësi, në xhehennem, e xhehennemi është i errët. Në qoftë se e doni dritën mos e harroni All-llahun dhe shkoni rrugës së Tij.

Edhe kësaj radhe babai e shfrytëzoi rastin dhe na e dha këtë këshillë të bukur. Fjalët e tij u varën në kokën tonë siç viren vathët në veshë.

E ne shtuam:

-Ne e duam dritën dhe rrugën me dritë. Ne e duam xhennetin që është dritë. O All-llah, ne frikohemi prej errësirës, andaj na shpëto nga errësira.

Përderisa ne i bënim këto biseda, nëna veçmë e kishte ndezur llambën e gazit dhe e vari në mur, kurse ne vazhduam ta hamë darkën me dritë.



## DJALI HALLALL

Ishte lodhur shumë për shkak se mundohej që të përkujdesesh për familjen sa më mirë, por të ardhurat që fitonte nuk ishin të mjaftueshme. Andaj vazhdimisht bënte përpjekje që të punonte edhe pas orarit të punës. Një ditë kur patroni pyeti:

-Kush do të rrijë rojtari natën? Ai i pari u përgjigj:

-Zotëria juaj, unë jam i gatshëm të bëj roje natën.


Një ditë në fabrikë erdhi një shok i patronit për t'i kryer disa punë. Puna ishte e tillë që kërkonte të punohej edhe pas orarit të punës.

Plaku me kënaqësi vendosi që t'i ndihmonte derisa ta kryente punën e filluar. Pas disa ditësh njeriu e përfundoi punën e tij. I mbledhi veglat kurse disa copa hekuri i la mënjanë, me ç'rast i tha plakut:

-Xhaxha, shumë faleminderit për kujdesin dhe ndihmën që ma bëre. Këto copa hekuri po i lë këtu, ndonjëherë kur do të kem kohë do të vijë për t'i marrë!

Plaku mbeti i shtangur dhe i habitur! Njeriu ia dha një falënderim të thatë e asgjë më tepër. Ditë me radhë sa ishte duke i ndihmuar, plaku





ëndërronte se çka do të bënte me paratë të cilat do t'ia jepte ky njeri. Nga hidhërimi derën e mbylli me të shpejtë, u ul për një çast, e pastaj me hov u ngrit nga vendi. E mori një thes dhe filloi ta mbushë me ato copa hekuri për të cilat, përveç që nuk u shpërblye prej zotërisë për ndihmesën e bërë, u ngarkua që të ketë kujdes për to derisa të vijë e t'i marrë. E hodhi thesin në shpinë dhe mori rrugën për në shtëpi. Me të arritur në shtëpi, sëpari e lëshoi thesin e pastaj mori frymë thellë.

Gruaja, e habitur e pyeti: -Çka është ky thes?

-Haku i atij që më mbajti disa ditë në punë e që nuk më pagoi. Ia mora këto copa hekuri, do t'i shes dhe do ta nxjerr hakun tim.

Djali i vogël i cili ishte në klasën e dytë, sapo ishte ngritur nga gjumi. Ashtu gjysëm i ngritur pushonte në shtratin e tij, por kur i dëgjoji fjalët e të jatit, mbeti shumë i habitur. Me të shpejtë u ngrit nga shtrati, iu afrua të jatit dhe i tha:

-Babë, a dëshiron të na ushqesh me haram. Të lutem babë, haramit me haram mos iu përgjigj.

Babai i tij u habit. Nuk i priste këto fjalë prej djalit të tij aq të vogël. Sytë iu mbushën me lot, e hodhi thesin në shpinë dhe përsëri mori rrugën drejt fabrikës. Duke iu dridhur buzët vazhdimisht i përshpëriste këto fjalë: "Falënderimi të qoftë ty o All-llah që ma bërë të mundur të

më edukohet ky djal me edukatë islame, që u bë djal hallall e që më shpëtoi nga rënia në haram.

## TË NDAHEMI QË NË DUNJA

Meqë e kishte kryer shkollën fillore, burrë e grua ishin ulur dhe diskutonin për ardhmërinë e djalit të cilin e kishin për hasret. Perëndia u kishte dhënë edhe fëmijë të tjerë por jetëshkurtër, të gjithë kishin vdekur të vegjël, ende pa e ngrohur gjoksin e prindërve me përkëdheljet e tyre. Megjithatë ishin besimtarë të vërtetë andaj nuk thonin asgjë pos fjalëve: "Prej All-llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi", fjalë që duhen të thuhën me rastin e ç'do fatëkeqësie.

All-llahu këtij djali ia kishte dhënë të gjitha të mirat e jetës përderisa e kreu shkollën fillore, por tani? Ai ishte një amanet, amanet shumë i madh dhe shumë i rëndë!

Pas thellimit në mendime e pas diskutimeve të gjata, vendosën që djalin ta regjistrojnë në medrese. Ardhmëri e lumtur në dunja, e të kënaqur edhe në ahiret edhe ai edhe ata.

Rushiti ishte i zgjuar por po aq edhe zemërdëlirë. Krahas të gjitha këtyre vlerave pozitive më me rëndësi ishte ajo që ai kishte një dashuri të thellë ndaj rrugës së All-llahut.

Çdo mësim që e përvetësonte njëkohësisht muntohej që ta zbatonte në jetë. Bënte përpjekje të vazhdueshme që ato mësimet të

jetësoheshin në familjen e tij, në rrethin ku jetonte dhe në tërë botën.

Në të vërtetë ai ishte shumë i vogël por zemra e tij ishte shumë e madhe. Mendohej dhe përpiqej për tërë njerëzinë. Dëshira e tij më e madhe ishte që i tërë njerëzimi t'u nënshtrohej urdhrave të Atij që krijoi e furnizoi ç'do gjë në botë.

Kështu i kalonin ditët në medrese.

Brenda javës me gëzim e priste ditën e pushimit që të shkojë në shtëpi. Kjo nuk do të thotë se ai në shtëpi e kalonte kohën kot, por atje e këshillonte familjen, i korrigjonte lëshimet që bëheshin dhe mendohej t'i përmirësonte me diturinë që kishte arritur ta përvetësojë brenda javës.

Një ditë mësoi se gruaja muslimane duhet të vishet me mbulesë dhe se asaj nuk i lejohet të dalë e zbuluar jashtë shtëpie. Ky urdhër nuk kishte të bënte me ndonjë dëshirë njerëzore por, ishte urdhër i All-llahut i theksuar në Kur'an në suren Nur, ajeti 31 dhe në suren Ahzab, ajeti 59.

Rushitit zemra iu ngushtua. Nëna!, -tha në vete. Jo nuk do të mund të duronte deri në fund të javës kështu që me të shpejtë erdhi në shtëpi.

E shkreta nënë, si edhe ç'do nënë tjetër u frikësua se mos i kishte ndodhur diç e keqe.

-Jo, nënë, mos u merakos, -i tha Rushiti. -Asgjë të keqe nuk kam, por kam ardhur të të tregoj se nuk po mund të bëjë gjumë të rehatshëm pa ta shprehur dashurinë që e kam ndaj teje.

-Nënë, të dua shumë, -iu drejtua djali me një zë melankolik.

-Edhe unë Rushit, biri nënës, -ia ktheu e ëma, e cila e tëra ishte bërë sy e vesh.

-Të lutem më kupto se të dua shumë, më beso nuk ta dëshiroj të keqen, -i tha i biri.

-As unë loçka e zemrës sime, -iu përgjigj e ëma të cilës zëri veçmë kishte filluar t'i ndryshojë.

-Dëgjo nënë se ç'farë ishte ajo që nuk më la të flejë që nga dita kur e kam dëgjuar. All-llahu me Kur'an urdhëroi që femra të mbulohet, dhe këtë urdhër të Zotit duhet zbatuar menjëherë. Nënë, të lutem, përgjigjju urdhrit të All-llahut?

-O biri i nënës, atë që e thua është e vërtetë, por ki durim pak, kjo nuk është punë e lehtë. Ti e di se asnjë nga shoqet e mia nuk i është përgjigjur kësaj thirrjeje.

-Oj nënë, nëse ke turp nga shoqet, unë kam turp nga All-llahu. Mbulesa për ty është farz. E ai që farzin e All-llahut nuk e zbaton në këtë botë do të ndëshkohet me zjarr në botën tjetër. Nëse vazhdon kështu ne medoemos do të ndahemi në Ditën e Gjykimit. Andaj më mirë po ndahemi që në dunja - ia tha këto fjalë me një



zë dridhës Rushiti të nënës së tij dhe doli nga dera e shtëpisë pa e kthyer kokën prapa.

-Rushit, Rushit biri im, kthehu, mos u ngut! - Por të kota ishin fjalët e nënës meqë Rushiti nuk u kthye.

Kaluan javë të tëra. Kaloi edhe java e tretë. Rushiti nuk erdhi më në shtëpi. Nëna e tij u përmallua aq shumë saqë nuk mundi të durojë e të mos qajë. E kuptoi gabimin e saj dhe e kuptoi se dëshira e të birit në të vërtetë ishte dëshirë e All-llahut. Andaj vendosi t'i përgjigjet All-llahut. Menjëherë ia behu në shkollë te i biri, e pa atë dhe e thirri: Rushit, Rushit eja shpirti i nënës!

Për një çast Rushiti e ktheu kokën dhe e pa të ëmën të mbuluar. Lotët e njomë i rridhnin rrëke nga gëzimi. Me të shpejtë vrapoi kah nëna dhe e përqafoi fuqishëm. Nga dënesjet nuk mund të thoshte asgjë tjetër pos fjalës: Elhamdulil-lah, elhamdulil-lah!

Kështu, All-llahu i bashkoi përsëri në dunja që t'i bashkojë edhe në ahiret.





## **NA MJAFTON KËNAQËSIA E ALL-LLAHUT**

Lajmi se në shkollë do të organizoheshin kurse për lëndët në të cilat disa fëmijë kishin treguar sukses të dobët u përhap me të shpejtë. Lavdërimi dhe Hasani ishin dy shokë të ngushtë dhe punëtorë. Njëkohësisht, ata ishin të sigurtë e të sjellshëm dhe në çdo pikëpamje dalloheshin nga shokët tjerë. Ata nuk kishin nevojë për kurset që ishin hapur. Por me qëllim që t'u ndihmojnë shokëve të tyre dhe arsimtarëve deri diku t'ua lehtësonin punën, vendosën që edhe ata të shkojnë në kurs.

Fatkeqësisht këta dy shokë të ngushtë rridhnin prej familjeve të varfëra, kështu që ishin të detyruar që pas orarit të shkollës të merreshin edhe me punë të tjera, e sidomos t'u ndihmonin baballarëve në punët e tyre të përditshme. Koha e kurseve ishte e caktuar në mbrëmje. Meqë detyrat medoemos duhej të kryheshin, nevojitet edhe një flijim i madh. Ata kishin vendosur t'u ndihmojnë vëllezërve të tyre përmes kurseve të hapura, pa kurrfarë shpërblymi, por vetëm për hir të All-llahut të Madhërishtëm. Do ta përballojnë edhe këtë. Pas shkollës në punë e prej pune në shkollë, që të



marrin pjesë në kurset e hapura. Pastaj të kthehen në shtëpi dhe t'i kryejnë detyrat. Duhet të ngrihemi në mëngjes, ta falim sabahun dhe të shkojmë në shkollë. O All-llah, na ndihmo! -u lutën që të dy.

Në fillim puna u shkonte shumë mirë. Nuk ndienin kurrfarë lodhjeje. Kënaqësia e të mirës që e bënë ata, i çlodhte. Pas disa javësh, kur fëmijët tjerë filluan t'i përvetësojnë mësimet, më nuk ua shprehnin respektin e mëparshëm. Madje filluan edhe t'i përbuzin. Kjo e lodhi dhe e dëshpëroi Hasanin sa që një ditë i tha Lavdërimit:

Vëlla Lavdërim, unë më nuk po mundem të qëndroj. Ne edhe në shkollë po shkojmë edhe familjeve po u ndihmojmë, tani edhe me shokët në kurse po shkojmë që t'u ndihmojmë. Lëre që nuk janë mirënjohës por tani kanë filluar edhe të tallen me ne!

Lavdërimi me një kujdes të madh e dëgjo shokun e vet të dashur dhe iu përgjigj:

-Hasan vëlla! Ne tërë këtë lodhje e tërë këtë flijim a thua për çfarë jemi duke e bërë?

-Për hir të All-llahut, për ta fituar kënaqësinë e Tij, -iu përgjigj Hasani.

-Atëherë o vëlla, pse brengosesh për atë që ata nuk janë mirënjohës ose për atë se ata tallen me ne. Na mjafton kënaqësia e All-llahut, e pas asaj asgjë tjetër nuk na duhet. Ne do ta vazhdojmë punën tonë.

-Ke të drejtë Lavdërim. Plotësisht ke të drejtë. Unë gabova, All-llahu më faltë, -tha Hasani. Ai tani me një dashuri dhe me vullnet edhe më të madh e vazhdoi punën për hir të All-llahut!

All-llahu i shtoftë shokët e këtillë!

## KI FRIKË NGA ALL-LLAHU

Naili dhe Nesimi ishin dy shokë të ngushtë. Kalonin shumë bukur saqë çdokush ua kishte lakmi për shoqërinë që kishin. Por, ja se ç'ndodh kur djalli ndërhyr dhe vesvesja fillon të punojë. Njëri prej tyre u ishte përgjigjur atyre. Për disa interesa të kësaj bote, për disa përfitime krejt të vogla u hidhërua me shokun që thoshte se e donte shumë. Por, nuk u ndal me kaq, ai filloi të flasë keq për të e madje edhe e teproi, siç ndodhë me njeriun kur fillon të shkojë prapa djallit ai e futë në mëkate edhe më thellë. Ai filloi edhe të bëjë shpifje për shokun e tij. Dalëngadalë kjo filloi t'i bëhej shprehi pasi me çdokën që takohej i thoshte:

-A e njeh Nesimin. Askush nuk mund ta njohë më mirë se unë. Unë isha shoku i tij më i ngushtë. Por, ai nuk është si mendoni, ai është kështu e kështu.

Mirëpo të gjitha këto thashetheme për shokun e tij të dikurshëm nuk i mjaftonin dhe nuk i sillnin kënaqësi. Andaj e ndërroi mënyrën e veprimit dhe kështu filloi t'i vizitojë njerëzit, e sidomos shokët e Nesimit, me qëllim që duke folur keq për të t'i bëjë edhe ata që të largohen prej tij. Një ditë Naili shkoi te Burhani dhe siç e



kishte marrë për detyrë dhe e kishte bërë zakon filloi të flasë keq për Nesimin. Por kësaj herë gozhda i hasi në gozhdë edhe më të madhe. Burhani ia ktheu:

-Ndëgjo Nail, me ajet kur'anor dhe me hadith të Pejgamberit rreptësisht është e ndaluar të flasish për dikend pas shpine, e sidomos ty nuk të ka hije aspak, sepse deri dje ke qenë bashkë me të dhe ke deklaruar se jeni shokë të ngushtë, e tani, me sa duket, shoqërimi yt sikur paska qenë vetëm për t'i zbuluar të fshehtat e Nesimit. Kjo që je duke e bërë vërtet është një mëkat shumë i madh. Frikohu All-llahut sepse këto veprime që i ke marrë përsipër, askush pos djallit dhe miqve të tij nuk i bekon. Nëse dëshiron ta fitosh mëshirën e All-llahut e mos të të kaplojë hidhërimi i Tij, atëherë pendohu por sinqerisht, duke vendosur që të heqish dorë nga këto punë të fëlliqura, pastaj kërko falje prej All-llahut se Ai i do ata që kërkojnë falje prej Tij. Poashtu është mirë t'i kërkojë hallallëk Nesimit, se meqë ai nuk e tha as një fjalë të keqe për ty sigurisht se ai do ta pranojë hallallëkun tënd.

Naili me fytyrë të skuqur dhe me kokë të ulur u largua nga Burhani pa thënë asnjë fjalë.

Në mendjen e Burhanit sillej mendimi, se a thua Naili do t'i përgjigjet ftesës së All-llahut apo ende do të vazhdojë ta miqësojë shejtanin. Në atë moment nuk dinte se çfarë të thotë tjetër, tha vetëm: All-llahu e udhëzoftë.





## NUK KA MEND

Ai ishte një femohues i rëndë. Nuk besonte në asnjë fe. Për të Zoti nuk ekzistonte fare. Atij nuk i mjaftonte mosbesimi e tij por mundohej që të bëjë shokë siç ishte vetë. Detyra që e kishte marrë përsipër aq mirë i përshtatej si të ishte ndonjë gëzof i porositur!

Me profesion ishte mësues. Do t'i arsimonte fëmijët! Mendjet e pastra fëmijërore i ishin lënë amanet dorës së tij. Ai do t'i edukonte dhe do t'ua mbushte trurin me idetë e bukura që i kishte! Një ditë kishte vendosur që ta zbatojë në praktikë planin që e kishte bërë që më parë. I mbushi xhepat me sheqerka dhe hyri në klasë. Fëmijët e pritën në këmbë si gjithëherë. Pasi i përshëndeti nuk u ul por e la ditarin mbi tavolinë dhe duke ecur nëpër klasë tha:

-Ju a besoni në All-llahun?

Të gjithë ishin muslimanë. Ishin të edukuar me besim në All-llahun. Të gjithë njëzëri iu përgjigjën: -Po, besojmë në All-llahun!

Mësuesi u ndal. Si t'i turbullojë këto mendje të pastra!

-A e shifni All-llahun?

Fëmijët u hutuan. Të gjithë njëzëri thanë:

-Jo, nuk e shohim!



Plotë gëzim vazhdoi:

-Thirreni All-llahun që e besoni, a do t'ju përgjigjet!

Të gjithë filluan të brohorisin:

-O All-llah! O All-llah!

Por asnjë përgjigje nuk u dëgjua.

Mësuesi ateist me krenarinë e komandantit që e ka fituar luftën, vazhdoi bisedën:

-A më shihni mua?

-Po, të shohim, -u përgjigjën nxënësit.

-Më thirrni mua, kërkoni sheqerka prej meje!

-O mësues, o mësues, na jep sheqerka!

-Urdhëroni o nxënësit e mi, unë jam këtu. -  
Dhe duke i hedhur mbi kokat e fëmijëve sheqerkat që i kishte në xhepa thoshte: -Urdhëroni sheqerkat, urdhëroni hani.

Pas një gjysëmpushimi përsëri iu drejtua fëmijëve: -O ju fëmijët e mi! Nuk duhet t'i besoni një sendi që nuk e shihni me sy!

Mendjet e pastra e të dëlira u turbulluan, nuk dinin se çka të thonin. I ulën kokat dhe heshtën.

Po në atë çast, u ngrit një dorë e vogël që të kërkojë leje për diskutim. Ishte ajo dora e Hatixhes për të cilën familja kishte dhënë mund të madh që ta edukonte si duhet. Mësuesi e vërejti atë dorë të vogël dhe tha:

-Urdhëro Hatixhe, deshe diçka të thuash?

-Po zotëri mësues, kisha disa fjalë për shokët dhe shoqet e mia.

-Me gjithë dëshirë Hatixhe!

-O shokë të mi! Mësuesi ynë tha se një send që nuk duket nuk ekziston. Tani unë dëshiroj t'ju pyes juve:

-A e shihni mësuesin?

Të gjithë brohoritën: -Po, e shohim.

-Ai është, andaj e shihni. Po a ia shihni mendjen?

-Jo, nuk ia shohim! -të gjithë u përgjigjën njëzëri.

Hatixheja vuri gurin në vend e tha: -Nuk ka mend mësuesi ynë, ndaj edhe nuk ia shihni. Të marrit, fort veshin mos ia vini.

## SHALQINI I IDHËT

Na ishte një njeri që ishte shumë bampirës. Atij ia kishin dhuruar një shalqi të madh të cilin nuk dëshironte ta hante vet. I tha shërbëtorit të tij: -Shko e ma thirr Llukman Hekimin se këtë shalqi dua ta ha së bashku me të.

Pas pak kohe Llukman Hekimi ia mbërrini. Nuk mund që tia refuzonte thirrjen, ngase këtij njeriu shumëherë ia kishte parë hajrin, ku ai e kishte vërtetuar bujarinë e tij.

Njeriu e ndau shalqinin pjesë-pjesë e pastaj ia afroi Llukman Hekimit. Llukman Hekimi menjëherë filloi t'i hante copat e shalqinit. Pas copës së parë vazhdoi me të dytën, tretën, kurse edhe copën e katërt e hëngri me kënaqësi të madhe. Njeriu tha me vete, ta provojë edhe unë një copë të shalqinit, por kur e kafshoi, iu idhëtua goja aq shumë, saqë nuk ishte në gjendje ta vazhdojë copën e parë.

I habitur, iu kthye Llukman Hekimit dhe e pyeti:

-Si është e mundur që ju i hëngrët tërë këto copa të shalqinit madje as pa e rrudhur fytyrën?

Përgjigjja ishte e tillë çfarë i takonte Llukmanit të urtë:



-I nderuari zotëri, aq të mira kam përjetuar dhe aq bujari kam parë prej jush, saqë kisha turp t'i them e idhët dhuratës të cilën ma ofruat me duart tuaja.

-Njeriu nuk bën të jetë bukëshkelës, por duhet të jetë falënderues për të mirat e All-llahut bujar. Ai nuk duhet ta ngrejë kokën për disa ligështi, në të cilat pjesë e sprovimit është edhe vetë ai.





## DRUVARI

Në kohën e Musait alejhisselam paska qenë një drubartës fukara. Drunjtë që i mbledhte në mal i ngarkonte në shpinë, i sillte në qytet, i shiste dhe me paratë që i fitonte e kalonte jetën.

Druvari nuk shqetësohej prej punës që e bënte edhe pse ishte e rëndë dhe lodhëse sa shqetësohej me fqin, të cilin kur e shihte me gomarin e ngarkuar me drunj, këtë aspak nuk mund ta duronte.

Por një ditë shkoi te Musa alejhisselam dhe filloi t'i qaj për gjendjen e vet të vështirë duke i thënë:

-Duke i bartur drunjtë mbi shpinë, në të më janë çelur varrë. Asnjëherë në jetën time nuk e kam përjetuar qetësinë e rehatinë. Të lutem, kur të takohesh me All-llahun mos harro t'ia paraqesish gjendjen time. Lute që të ma japë një gomar për të bartur dru.

Kur Musai alejhisselam shkoi dhe u takua me madhërinë e All-llahut, ia paraqiti dëshirën e druvarit.

All-llahu i madhëruar i tha:

-Ky rob imi vuan nga sëmundja e xhelozisë. Ai nuk mund të gjejë qetësi përderisa nuk shpëton prej sëmundjes që e ka. Në radhë të



parë ai duhet të lirohet prej kësaj sëmundjeje e pastaj ta kërkojë rehatinë. Po, ti thuaji se është sëmurë gomari i fqiut, le të lutet që t'i shërohet gomari atij, e Unë do t'i jap këtë një gomar.

Kur Musai alejhisselam ia solli porosinë e All-llahut, druvarit iu ngrit damari i xhelozisë dhe tha: -Unë nuk mundem t'i lutem Zotit që t'ia shërojë gomarin fqiut. Unë do të mbetem i kënaqur me gjendjen time, madje as nuk dua gomar nëse All-llahu ia shëron gomarin fqiut tim.

S'ka dyshim se xhelozia është sëmundje shumë e keqe. Ai që vuan nga ajo kurrë nuk do të jetë i kënaqur. Sa e turpshme është gjendja kur fukaranë më shumë e ka lodhur dhe nuk e ka lënë të gjejë rehati xhelozia se sa drunjte që i ka bartur mbi shpinë.

Sa bukur e sqaroi këtë të vërtetë Muhammedi alejhisselam kur tha:

“Mos u bëni xheloz, se xhelozia i ha të mirat ashtu si zjarri që i ha drunjte”



## KULETA


Njëherë një tregtari duke ecur nëpër çarshi, ia vodhën kuletën në të cilën kishte pasur tetëqind flori.

Ishte endur në të djathtë e në të majtë, megjithatë nuk kishte takuar asnjërin që e kishte gjetur ose vallë e kishte parë kuletën e tij. Menjëherë angazhoi një telall, dhe shpalli se kush ia sjell paratë ka për t'i dhënë njëqind flori dhuratë.

Kuletën e vjedhur e gjeti Veliu i cili punonte si këpucëtar e që ishte njeri shumë i drejt. Ai kishte vendosur mos ta paraqes kuletën e vjedhur derisa të lajmërohet i zoti i saj. Por kur e dëgjoi zërin e telallit, kishte shkuar drejt e te tregtari dhe ia kishte dorëzuar kuletën.

Tregtari ishte koprrac i madh dhe rrenacak. Ishte person që nuk e çmonte të mirën. Ai ishte gëzuar shumë për gjetjen e të hollave por gëzimin e tij nuk e shprehu publikisht. Menjëherë e hapi kuletën dhe pasi që i numëron të hollat tha: -O ti shok! Ti i paske marrë të hollat që duhet t'i marrish.

Kështu ai përveç që i merr të hollat i bëri edhe shpifje këpucëtarit.



Këpucëtar Veliu e kapi për jake tregtarin dhe i tha:

-Shiko zotëri, unë vërtet jam i varfër por nuk jam rrenacak e as tradhtar. Ti mundesh të mos m'i japish të hollat të cilat i ke premtuar, por nuk mund të më akuzosh se unë t'i kam marrë ato.

Kur tregtari vazhdoi me shpifjen, kadiu i atij vendi vendosi t'i nxirrte në gjyq. Pasi që i dëgjoji të dy palët, e kuptoi mirëfilli se tregtari ishte rrenacak. Por, kur tregtari u betua se kishte të drejtë, kadiu u hidhërua edhe më tepër kështuqë vendosi që t'i jepte një mësim të mirë tregtarit. Duke mos e shprehur hidhërimin, ai e shqiptoi vendimin:

-Tregtari thotë se njëqind flori i janë marrë kurse këpucëtari thotë se nuk i ka marrë. Kështu, siç po kuptohet të dy e thonë të vërtetën. Nga kjo kuptohet se kuleta të cilën e ka gjetur këpucëtari nuk është e tregtarit, por e dikujt tjetër. Kuleta do të merret derisa të paraqitet pronari i vërtetë. Tregtari dorështrënguar u pendua shumë për atë që e bëri, por, tashmë ishte shumë vonë. Sjellja e këtij tregtari na e përkujton hadithin e Pejgamberit alejhisselam në të cilin thotë: "Ai që nuk i falënderon njerëzit, nuk e falënderon as All-llahun."





## **E VËRTETA ME EMRIN VDEKJE**

Ishte një ditë e nxehtë vere. Vapa ishte aq e madhe sa që në ato çaste çdo kush ishte strehuar ashtu siç kishte mundur. Lagjen e kishte përfshirë një qetësi e rrallë. Një plak pa se ishte afruar koha e ezanit, kështu që filloi të përgatitet për namaz. Më pas kur u nis drejt xhamisë duke ecur dalëngadalë, për një çast vrapoi një fëmijë dhe duke u kthyer në një skaj të rrugës u përplas me plakun. Plaku ia priti:

-Biri im çke që vrapon në këtë mënyrë? A ke ndonjë dert? Pse nxiton kaq me turr?


-Në xhami ia kam mësyer, o xhaxha, -iu përgjigj fëmija që mezi mbushej frymë.

-Ooo sa bukur! Kaq i vogël e po shkon në xhami, -i tha plaku.

Në këtë fëmija pasi që morri frymë thellë iu përgjigj:

-O xhaxha! Në këtë punë a ka të vogël e të madh? Dje vdiq një fëmi edhe më i vogël se unë. E vërteta me emrin vdekje nuk bën kurrfarë dallimi, qoftë personi i vogël o i madhë. Secili, pa marrë parasysh vitet, duhet të jetë i përgatitur për vdekjen.

Plaku u shtang nga habia dhe filloi të flasë vetë me vete:



“O sa çudi! Atë që të mëdhenjtë duhet ta mendojnë, e mendon një fëmi!

Lavdia të qoftë ty o Zot, udhëzimi është në duart Tua!”



## DREJTËSIA DHE RESPEKTI

Kur nëna hyri në dhomë, e pa llambën e tavolinës të thyer. Macja ishte duke luajtur me të. Ajo mendoi se macja e kishte thyer atë, andaj dashti ta qortojë por në atë moment Xhevati iu lut:

-Mos e qorto macen nënë! Ajo nuk ka faj. Llambën e theva unë. Pasi i kreuva detyrat e shtëpisë duke i mbledhur librat, nuk e di por Padashtas shtyra llambën e ajo ra. Unë desha t'ju tregoja, por meqë babai ishte duke ngrënë drekën, nuk desha t'ua prishë qetësinë për atë që ndodhi. Nëna u gëzua shumë nga fjalët e sinqerta që i dëgjoji nga i biri prandaj i tregoi babait të Xhevatit, e ai, meqë mbeti i kënaqur tha:

-Tregimi i drejt i Xhevatit dhe respekti i tij për më të vjetrit, na bënë që t'ia falim gabimin. Por jo! Kjo nuk do të mbetet vetëm me kaq, por ai meriton të shpërblehet për këtë drejtësi dhe respekt.

Prandaj unë ia kam falë gabimin e bërë dhe do t'i blejë një llambë më të mirë dhe më të bukur se që e kishte.

Të dashur fëmijë, mos u largoni nga drejtësia, sepse vetëm ajo ju ndihmon që ta gjeni rrugën e drejtë! Mos keni frikë për respekt sepse vetëm drejtësia e sjell respektin!



## PJATA PREJ PLASTIKE

Plaku kishte punuar një kohë të gjatë si zdrukhtarë. Ishte i rraskapitur nga puna e vështirë dhe barra e viteve në kurriz e madje edhe sytë e kishin lënë. Nuk kishte më fuqi. Duart e tij plotë rrudha vazhdimisht i dridheshin, prandaj sa herë që hante, gjella i derdhej në sofër. Djali dhe reja e tij e qortonin pse nuk kujdesej më tepër. Pas disa ditësh vendosën ta ndanin nga sofa, kështuqë plaku ushqimin duhej ta hante vetëm. Nipi i tij Hasani u brengos shumë për gjyshin e tij. E shihte me keqardhje gjyshin që ishte i detyruar të rrinte i dëshpëruar dhe i vetmuar.

Një ditë, duke e ngrënë drekën, plaku e rrëzoi dhe e theu pjatën. Pas kësaj vendosën që plakut t'i japin ushqim në pjata plastike. Një ditë djali i plakut i tha gruas së vet:

-Mos i vë frutat në pjatat e plastikës! Hedhi ato, se kam blerë të tjera.

Hasani tejet i brengosur për gjyshin, iu drejtua prindërve të vet:

-Mos i hidhni këto pjata se do të më duhen në të ardhmen.

Ata u habitën dhe e pyetën Hasanin përse do t'i duhen pikërisht këto pjata.





-Kur do të plakeni ju, -tha Hasani, do t'ju jap gjellë nga këto pjata ashtu siç po i jepni ju gjithë tani.

Ata e kuptuan se kishin gabuar dhe se kishin bërë një vepër të shëmtuar ndaj prindit dhe se vepra e mirë që ia hap njeriut dyert e xhennetit është nderimi i prindërve. Sa bukur ka thënë Pejgamberi ynë, Muhammedi alejhisselam: "Kënaqësia e All-llahut fitohet me kënaqësinë e prindërve, ndërsa moskënaqësia e All-llahut fitohet me hidhërimin e tyre."



## KËPUCËT


Bënte një dimër tejet i ftohtë. I ftohtë ishte edhe për Mehmetin i cili mbathte njëpalë këpucë plotë vrima, nëpër të cilat depërtonte uji dhe ia lagte këmbët e tij të njoma. S'do mend se edhe ai kishte dëshirë që të mbathte këpucë të mira, por barra e rëndë e varfërisë nuk ia lejonte. Shpesh mendonte vetë më vete: "Ah sikur të kisha ca para, vetëm për të blerë rroba të reja, këpucë të forta dhe një xhaketë dimri."

Një ditë derisa po kthehej nga shkolla, vërejti se ishte koha e namazit të ikindisë. Ai e donte shumë faljen e namazit, andaj ktheu në xhami për ta falë ikindinë me xhematë. Derisa po bëhej gati për të marrë abdest, vërejti se këmbët i ishin lagur, andaj me hidhërim i hodhi këpucët në tokë. Po në atë çast, përballë tij vërejti një njeri tjetër që po merrte abdest, se si po e pastronte njërën këmbë por tjetrën nuk e kishte fare!

Tani Mehmetit iu hoq ajo mërzi e ai mendim që e kishte më parë. Para syve të tij vazhdimisht e kishte njeriun që nuk e kishte këmbën. Vërtet, ai mund të kishte para për të blerë rroba të shumta, xhaketa e këpucë, por me para nuk mund të blehet çdo gjë, me para nuk mund ta



blente këmbën e tij. Pasi e fali namazin, me një mendim krejt tjetër nga ai që e kishte më parë, iu lut All-llahut të madhëruar dhe e falënderoi Atë për të dy këmbët e shëndosha që ia kishte falur.



## LOPA E VERDHË

Plaka Aishe kishte mbjellur groshë në kopshtin e saj. Meqë koha mbajti bukur, grosha shumë shpejt lëshoi filiza

Një ditë zëri i një lope që pëlliste dhembshëm e nxori me të shpejtë nga shtëpia. Por çfarë të shihte, lopa e verdhë e fqiut kishte hyrë në kopsht dhe e kishte shkelur groshën e cila kishte filluar të lëshojë filiza.


Plaka e hutuar u step në vend kur pa se i tërë munda i kishte shkuar huq. Përderisa lopa e verdhë pëlliste para derës së ahurit, plakën e kaploi hidhërimi, mori një shkop dhe u turr drejt lopës.

Po në atë moment gruaja e fqiut erdhi me vrap dhe filloi të arsyetohej me një zë të mërzi-tur:

-Të shkretës, dje i ka ngordhur viçi. Prej mëngjesit tri herë e ka këputur litarin duke e kërkuar viçin.

Plakës Aishe kur i dëgjoji këto fjalë, i ra shkopi nga dora. Ajo tani filloi t'ia lëmojë kokën lopës së verdhë, e cila veçmë u ishte afruar pranë.





-Edhe kjo e shkretë mërziteshka për fëmijën e saj, -thoshte plaka Aishe, ndërkohë që groshën krejt e kishte harruar.

Sjellja e mirë e plakës Aishe sa bukur përputhet me fjalën e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur tha:

"Kini mëshirë ndaj atyre që janë në tokë, do të kenë mëshirë për ju ata që janë në qiell."



## MJEKRA E PRIFTIT

Na ishte një prift fytyrëmërrorur e me mjekër të gjatë deri në brez. Vite të tëra kishte jetuar nëpër kisha. Ai jetonte në to duke u shtyrë me inat për të mos besuar në Fenë e vërtetë islame, edhe pse ka herë e kishte kuptuar të vërtetën e saj. Ai me qëllim nuk donte që ta shihte rrugën e drejtë. Një ditë u takua me një musliman të vërtetë. Muslimani ia shtroi një pyetje të tillë priftit të cilën ai nuk e kishte pritur!

-Më thuaj a je ti më i madh apo mjekra yte? - pyeti muslimani.

Prifti e shikoi çuditshëm dhe ia priti:

-Normalisht unë jam më i madh. Unë jam lindur pa mjekër dhe deri në rini kam qenë pa mjekër, -vazhdoi prifti.

Muslimani i tha:

-Atëherë turp të qoftë! Mjekra më e vogël se ti, por megjithatë ta paska kaluar. Shiko se sa qenka rritur dhe si qenka zbardhur. Nuk i paska mbetur asnjë shenjë prej gjendjes së parë, ndërsa ti kurrsesi të ndryshosh. Ende sillesh me inat dhe vazhdon me të njëjtin terk. Assesi të hysh në rrugën e ndriçuar të Fesë islame. Nëse nuk e përmirëson veten, duke e marrë shembulmjekrën tënde, medoemos rruga të cilën e ke zgjedhur do të të shpie në xhehennem.



## DETYRA E ROBËRISË

Na ishte një fukara që mendohej sa për një copë bukë që të mbijetojë. Një ditë pa disa njerëz të hipur në kuaj të bukur e të veshur me rroba të shtrenjta. I habitur pyeti: -Këta njerëz, mbretërit e cilave shtete janë?

Ata që e dëgjuan qeshën dhe i thanë:

-Këta njerëz nuk janë mbretër por janë shërbëtorët e valiut të Horosanit.

Njeriu i varfër duke e tundur kokën tha:

-O Zoti im, shihe këtë punë. Unë jam rob Yti por nuk e kam vlerën e robërve të valiut.

Këto fjalë ishin shprehje e pakënaqësisë me caktimin e All-llahut.

Kaloi një kohë. Valiu i Horosanit për shkak të një akuze hidhet në burg. Po ashtu i kapën edhe shërbëtorët e tij. I pyetnin për florinjtë dhe pasurinë e valiut se ku i kishte fshehur. Edhe pse kundër tyre ushtruan lloj-lloj dhune ata i mbetën besnikë valiut. Shpirtin e dhanë por fshehtësitë e zotëriut të tyre nuk i zbuluan, meqë nuk dëshironin që t'i përbuzin të mirat e zotëriut të tyre.

Njëri prej atyre që kishte dëgjuar për këtë ngjarje, erdhi te fukaraja dhe ia tha këto fjalë:



-O fukara i mjerë! Ja, a po e sheh se çfarë është robëria e vërtetë. Ke rastin të mësosh prej shërbëtorëve se si duhet të jetë njeriu rob i All-llahut. Krahaso robërinë tënde me robërinë e tyre. Mos kërko prej All-llahut atë që nuk e meriton.





## SHISHET E SYÇAKËRIT

Na ishte një djalosh syçakër. Ai çdo gjë e shifte çift dhe kjo i shkaktonte vështëresi të mëdha. Një ditë u punësua si çirak te një mjeshtër. Punonte me të gjitha forcat dhe mundohet që fitimin ta kishte hallall. Një ditë mjeshtri e thirri dhe i tha:

-Im bir, shko menjëherë në shtëpinë time, në dollapin e sallanit do të shohish një shishe, merre atë dhe ma sjell me të shpejtë.

Çiraku me vrap shkoi në shtëpinë e mjeshtrit. Me të hyrë në shtëpi shikoi nga dollapi por për habi, pa se aty ishin dy shishe. Nga hutia nuk dinte se cilën ta merrte. Vendosi të kthehet mbrapa dhe përsëri ta pyeste mjeshttrin.


Me atë rast, mjeshtri ia ktheu: -Biri im, nëse t'i je syçakër e të duken dy shishe, në dollap ka vetëm një.

-Jo zotëri, -ia priti çiraku, -aty vërtetë ishin dy shishe.

Mjeshtri u hidhërua dhe i tha:

-Nëse është ashtu shko, njëren theje e tjetrën sillma.

Çiraku me të shpejt shkoi te shtëpia. Mori njëren shishe dhe e theu, por për çudi, edhe tjetra u tret!



-Heu bre! -tha çiraku. -Mjeshtri im paska patur të drejtë. Me të vërtetë paska qenë vetëm një shishe. Unë pse jam syçakër s'do të thotë se aty kishte dy shishe. Njerëz të tillë si unë ka shumë, të cilët në vend se ta pranojnë të vërtetën ashtu si është, pasi i kanë zemrat çakër të gjitha gjërat i shofin dyfish dhe kështu marrin rrugën e shtrembërt. Në vend se ta pranojnë All-llahun Një, ata ia bashkangjesin shejtanin dhe kështu marrin rrugën e të mallkuarit. Rruga e drejtë është një dhe e vetme. Në vend se ta ndjekin këtë rrugë e cila quhet Islam, ashtu siç e ka emërtuar Ndërtuesi i saj, ata marrin rrugën e zjarrit.

Mjerë, e shumë mjerë për ato shishe që thehen.



## PO TË THONIN SE ËSHTË DEVE

Një njeri plak pa një dhelpër se si po ikte me shpejtësi të madhe dhe e pyeti:

-Çka ke, mos vallë je në ndonjë rezik të madh?

Dhelpra, e mbushur plot frymë, u ndal dhe iu përgjigj:

-Po, jam në një rezik të madh. Kam dëgjuar se janë duke u ndjekur devet, zihen dhe ngarkohen për punë.

Plaku mbeti i habitur nga kjo përgjigje:

-Mori dhelpër, -i tha, a po të duket që shumë po i përngjan deveve që aq po frikësohesh?

Dhelpra lëkundi kokën, e shikoi njeriun, dhe sikur e thelluar në mendime i tha:

-Mos thuaj ashtu, se nuk dihet. Del ndonjë shpifës dhe duke bërë me shenjë kah unë thotë: "Ja ku është edhe një deve". Atëherë mjer për mua, sepse derisa ta vërtetojnë se nuk jam deve lëkura më shkon. A nuk e ke dëgjuar fjalën e urtë që thotë:

"Ik prej njollës së shpifjes se edhe nëse nuk të zë shpifja, njollat e saj lënë shenjë"







## ***Përmbajtja***

---

DY TRI FJALË .....	3
SIKUR TË ISHTE NË RRUGË TË KEQE .....	6
DRITA.....	10
DJALI HALLALL.....	14
TË NDAHEMI QË NË DUNJA.....	18
NA MJAFTON KËNAQËSIA E ALL-LLAHUT.....	24
KI FRIKË NGA ALL-LLAHU .....	28
NUK KA MEND .....	32
SHALQINI I IDHËT .....	36
DRUVARI.....	40
KULETA.....	44
E VËRTETA ME EMRIN VDEKJE .....	48
DREJTËSIA DHE RESPEKTI.....	52
PJATA PREJ PLASTIKE .....	54
KËPUCËT .....	58
LOPA E VERDHË .....	62
MJEKRA E PRIFTIT .....	66
DETYRA E ROBËRISË .....	68
SHISHET E SYÇAKËRIT.....	72
PO TË THONIN SE ËSHTË DEVE.....	76

**Redaktor gjuhësor**

Ymer Musa

**Lektor**

Fatmire Ajdini - Hoxha

**Ilustrimet dhe kopertina**

Smajo Musoviq

**Përgatitja dhe shtypi**

*Focus* – Shkup

**Boton**

Qendra Islame Kulturore Shqiptare

Staten Island – New York

Tel. 1 718 618 9865

Sporod mi sl eweto na Ministerstvoto za kultura br. 07-4259/2 od 16.08.1999 g. za knigata *Det et o hal al se pla}a* povlastena dano~na stampa.

Sipas mendimit të Ministrisë për Kulturë nr. 07-4259/2 të datës 16.08.1999, për librin *Djali hallall* bëhet pagesa e lehtësuar tatimore.



*Qendra Islame Kulturore Shqiptare - New York*

## DHULKARNEJN VARDARI

U lind në Shkup më vitin 1962. Në vitin 1967 së bashku me prindërit u shpërngul në Stamboll. Mësimet fillore pesëvjeçare i kreu në Stamboll, me ç'rast me mbarimin e tyre përfundoi edhe hifzin e Kur'anit në vitin 1974. Më pas deri në vitin 1980 u ul para dijetarëve islamë dhe sipas metodave klasike i studioi dituritë elementare islame si dhe gjuhën arabe. Shkollën e mesme e kreu në Siri në vitin 1986, ndërsa studimet universitare i mbaroi në Kajro, në Universitetin e Ez'herit, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Arabe. Me të

mbaruar të studimeve në garat për hifz zuri vendin e dytë, por meqë ishte shumë i fortë në hifz, u dekorua me shpërblimin e dedikuar për vendin e parë, shkuarjen në haxh. Gjatë studimeve ishte aktiv në disa fusha. Ndhmoi shumë në afrimin e rradhëve ndërmjet studentëve turq, të ideologjizuar nga kuloare të caktuara xhematesh si dhe ishte urë e gjallë lidhëse ndërmjet tyre dhe studentëve shqiptarë. Që nga viti 1989 mbante kontakte të rregullta me xhematin musliman shqiptar në New York, kurse nga viti 1990 ishte në shërbim të imamit në xhaminë e Komunitetit Shqiptar të Staten Island të New York-ut. Në vitin 1992 me ndihmën e Komunitetit Musliman Shqiptar ngriti nis-mën për themelimin e një qendre islame kulturore shqiptare në Staten Island me ç'rast u ble vendi, u ngrit godina dhe në vitin 1995 u bë hapja solemne e saj. Me këtë rast vlen të përmendet se xhamia e kësaj qendre është xhamia më e madhe në Amerikë dhe Kanada. Prej këtij viti akademik (1999/2000) po në të njëjtin objekt do të fillojë edhe mësimi i rregullt fillestar, parashkollor dhe shkollor. Me rastin e shpërthimit të luftës në Kosovë, kjo qendër në krye me autorin e librit vunë kontaktet me ata që e bartën në krah fatin e Kosovës nëpër-mjet flijimit të jetës dhe i ndihmuan fuqimisht me të gjitha mjetet e nevojshme. Që nga viti 1994, Dhulkarnejn Vardari ushtron detyrën e drejtorit të kësaj qendre si dhe të imamit të xhamisë së saj.